



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:210526

Datë: 17.12.2019

Numri i dokumentit: 00744128

P. nr. 1009/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Adem Shabani me zyrtares ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit V.R, me vendbanim në Ferizaj në rrugën ..., nr...., për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.5 lidhu me par 4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.1631-9/19 të datës 18.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor- fillestar në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit shtetit Valdet Avdiu, dhe të akuzuarit V.R, me datën 17.12.2019, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **V.R**, me vendbanim në Ferizaj në rrugën ..., nr..., i lindur më ..., në Ferizaj ku edhe jeton, nga i ati L... dhe e ëma V..., e gjinisë Krasniqi, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri,-

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

- me datë 01.09.2019, rreth orës 16:00, në rrugën ..., në Ferizaj, saktësisht në oborrin e tij, ka penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, në atë mënyrë që derisa zyrtarët policor B.V dhe A.B, kanë qenë arrestuar për ta arrestuar personin A.R, i pandehuri del nga shtëpia me një thikë, në dorë, ka shkuar në drejtim të policisë duke bërtitur “ mos e prekni, mos e ngucni vllahun tim “, pas reagimit të policëve i njëjti e gjuan thikën në tokë dhe më pas arrestohet nga policia,-

- me këtë ka kryer veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.5 lidhu me par 4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4, 6, 7, 23, 38,46, 47, 48,,49 69,70,71,72 paragrafi 1 nën par 1.5. të KPRK-së, Kodin Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06-L- 074 dhe neneve 365 dh 450 të KPPK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

Të pandehurit **V.R** i shqipton dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 8 / tetë muaj, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 2 /dy / vite pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë nuk do të kryej veprë tjetër penale.

Të dëmtuarit-zyrtarët policor në Stacionin Policor në Ferizaj, B.V dhe A.B, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit janë udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i pandehuri i, të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 Euroë, dhe për taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.108-2/16 të datës 17.04.2018, , e ka ngarkuar të pandehurin A.RR nga fshati ..., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nën par 2 lidhur me nën par 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.20.12.2019, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedini i akuzuari V.R. kurse të dëmtuarit zyrtarë -policët B.V dhe A.B janë ftuar me ftesa të rregullta ku nga fletë kthesat për dorëzim personal konstatohet se i kanë pranuar ftesat në mënyrë të rregullt, por mosardhjen nuk e kanë arsyetuar.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurorja e shtetit i ka lexuar aktakuzën të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjti i ka dhënë mundësi të deklarohe mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I pandehuri V.R, ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i kërkon falje palëve të dëmtuarave edhe pse nuk janë prezent në seancë gjyqësore, dhe kjo ka ndodhur kur policia kishin ardhur për të më arrestuar vllahun tim A... dhe unë isha në

gjumë dhe kamë ndier një zë në oborr dhe pa dal jashtë për të shikuar se kush është kamë shkuar në kuzhinë dhe kam marrë një thikë të bukës, por kur kam dal jashtë nuk e kamë ditur se janë policia dhe ato më kanë urdhëruar që ta gjuaj në tokë thikën ku edhe e kamë gjuajtur dhe jam kthyer brenda në shtëpi por të nijetit kanë hyrë brenda dhe më kanë arrestuar dhe më kanë dërguar në polici ku edhe kamë dhen deklaratë për këtë rast është, nuk kamë pas qëllim që ti pengoj policët në kryerjen e detyrës së tyre, por kamë menduar se dikush është duke e sulmuar vllahun tim, është hera e parë që ndeshem me ligjin në të ardhmen gjithherë do të jem i kujdesshëm në verimet e mija jam i moshës së re i pa martuar, gjendjen e ekonomike nuk e kamë të mirë i pa punë i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të mere për bazë të gjitha rrethana lehtësuese.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit së shtetit me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi mbështetet edhe me provat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njëjtin ta pranoj si të tillë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale ,raportin e oficerit, vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve të dt.01.09.2019, si dhe në provat tjera që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.5 lidhu me par 4 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të neneve 69, 71,72 paragrafi 1 nën par 1.5. të KPRK-së Kodin Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06-L- 074 si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës penale, sjelljen e tij korrekte, pendimin e shprehur, se është hera e parë që ka kryer ndonjë vepër penale, kërkim falje shprehu të dëmtarëve- policëve, nuk ka pas qëllim që ti pengoj policët në kryerjen e detyrës së tyre, i gjendjes së dobët ekonomike, si rrethana rënduese gjykata kundër të pandehurit mori se i pandehuri i ka penguar personat zyrtar gjatë kryerjeje së detyrës zyrtare, që në kohëve të fundit është duke u përsëritur shpesh nga të pandehurit, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale, mbi bazën e këtyre rrethanave të tilla gjykata konform nenit 75 dhe 76 paragrafi 1 nën par 1.3 të KPK-së për të pandehurin A.RR, bëri zbutjen e dënimit dhe i vërtetoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 8 / tetë / muaj, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 2 / dy / vite pasi ky aktgjykim të merre formën

e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, të paraparë me nenin 38 të KPRK-së, Kodin Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06-L- 074 ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së - të dëmtuarit-zyrtarët policor në Stacionin Policor në Ferizaj, B.V dhe A.B, për realizimin e kërkesës pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.1009/2019 me datë 17.12.2019

Zyrtarja ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.